

V E N D I M
“ Ne Emer te Republikes”
“Per sekuestrim dokumentash”

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sot në datë **14.11.2012 ora 11.30**, trupi gjyqësor i përbërë nga:

Gjyqtare: Eneida CIVICI

asistuar nga sekretare e seances Soeda Docaj, mori në shqyrtim kërkesën penale me nr.1574, akti që i përket :

KERKUES : Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Danilea Sulaj.

OBJEKTI : Sekuestrimin e llogarive bankare.

BAZA LIGJORE : Neni 210 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, prokurori kërkoj :

Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarite bankare në vlerën (.....)USD, derdhje nga shtetasi (.....) me Nr. Llogarie (.....)

Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarite bankare në vlerën (.....) USD, derdhje nga shtetasi (.....) me nr. Llogarie (.....)

Gjykata pasi degjoi prokurorin shqyrtoi aktet shkresore dhe analizoi ceshtjen në teresi

VEREN

Në datë 12.11.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 5328 për veprën penale të “pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga studimi i materialit kallezues rezulton se shtetasi kinez (.....) i datëlindjes (.....) me pasaportë nr. (.....), në datë 08.11.2012 ka depozituar cash në bankën “Alfa Bank” shumë (.....) dhe në të njëjtën ditë ka kërkuar transferimin e këtyre fondeve, (transfer të cilave ende nuk është ekzekutuar nga Alfa Bank) ku përfituesi i këtyre fondeve është shtetasi (.....), banka Industrial Bank Co, nr. Ibani: (.....) dhe kodi swift (.....) Kinë.

Sipas informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë rezulton se, transaksionet dhe detajet e kryera në **Alfa Bank** nga shtetasi (.....) janë si vijon:

- Në datë 26 janar të vitit 2011 shtetasi (.....) është paraqitur në bankë për të vendosur marrëdhënie biznesi me bankën dhe aktualisht rezulton se, zotëron dy llogari personale në monedhën EUR e USD;
- Në datë 25/01/2012 shtetasi i mësipërm ka depozituar shumë (.....) dhe ka deklaruar se të ardhurat janë nga puna në Shqipëri;
- Në të njëjtën ditë ka kryer dy transfera në nisje përkatësisht në shumat (.....) dhe (.....), me bankë përfituese (.....) Industrial Bank Co, LTD dhe palë përfituese shtetasin (.....) për transfer të parë dhe palë përfituese shtetasin (.....) për transfer të dytë;
- Llogaria e klientit nga data e çeljes në vitin 2011 deri në datën e kryerjes së dy transferave në vitin 2012 ka qënë jo aktive, pra për gati një vit;
- Në llogarinë në monedhën EUR shtetasi (.....) nuk ka kryer asnjë transaksion.

Ka raportime të tjera për transaksione në vlera si: Më datë 12.10.2009 në **Alfa Bank** shtetasi (.....) ka derdhur cash shumën (.....), burimi i të ardhurave është deklaruar nga biznesi. Te gjitha veprimet e mesiperme bankare, janë kryer nga shtetasi (.....) ne banken “**ALFA Bank**” me qender ne Tirane.

Shumat e depozituara nga shtetasi (.....) në total arrin në shumën (.....) brënda vitit 2012 dhe per to eshte deklaruar te ardhura nga bizensi.

Nga kërkimet në QKR me gjeneralitetet (.....) rezultoi i rregjistruar subjekti, “**CHRM GUANG**” shpk, me **Nipt K31412071G**, rregjistruar në datë 12/02/2003, selia e ushtrimit të aktivitetit është “Rr.Dibrës, pranë Medreses Tiranë. Objekti i veprimtarisë nuk është i plotësuar. Përfaqësuesi ligjor është (.....), me status aktiv, ndërsa nga informacioni i marrë në Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve rezulton se, që nga viti 2009 ky subjekt është pasiv dhe ka kaluar tek Drejtoria e Tatimeve Tirane.

Shumat e depozituara nga shtetasi (.....) në total arrin në shumën (.....) brënda vitit 2012 nderkohe qe ashtu sic u theksua me siper rezulton se aktiviteti i biznesit te tij eshte pasiv. Pra nuk justifikohet burimi i te ardhurave tedeklaruar me shumen e depozituar dhe gjendjen e aktvitetit te bisnezit te deklaruar prane tatim taksave. Keto shuma janë depozituar të gjitha në para fizike, fakt që e bën edhe më të dyshimtë per pastrim parash dhe per faktin se ka kryer transferimin e menjëhershëm të fondeve jashtë vendit në të njëjtën ditë që i ka depozituar;

Mosparaqitja në bankë e asnjë dokumenti për justifikimin e kryerjes së transfertave, përveç se ka deklaruar ‘transfertë personale’, ç’ka e bën të pakuptueshëm qëllimin e vërtetë të destinacionit të tyre, si edhe fakti qe nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues për burimin e vërtetë të ligjshëm të fondeve dhe mbajtja për gati nje vit e llogarisë inaktive dhe përdorimi i saj vetëm për derdhje CASH e për transferime drejt Kinës, atëherë lindin dyshime për burimin e të ardhurave të investuara dhe qarkulluara në sistemin bankar.

Nga te dhenat e sistemit TIMS te paraqitur si prove ne gjykim rezulton se ekzistonjne dy shtetas me të dhëna, (.....) datelindja (.....)me pasaport nr. G00103113 skaduar date 03.08.2005 dhe G19428510 skaduar date 10.10.2011 dhe shtetasi (.....) **datelindja (.....)me pasaport nr(.....)-CN, date e skadimit 25.04.2021. (te dhenat e te cilit perputhen me te dhenat te cilat mban kopja e pashaportes e dorezuar nga derdhesi I parave prane Alfa Banka) .**

Gjithashtu nga te dhenat e ketij sistemi rezulton se tek hyrjet ne Republikën e Shqipërisë rezultoi se shtetasi (.....), hyrjen e fundit e ka me dokumentin, pasaporte e zakonshme kineze, me numër (.....)-CN, date **09.09.2012, ora 17:49**, me Fugon Targa (.....), Pika Kufitare Morina . Tek daljet nga Republika e Shqipërisë rezultoi se shtetasi (.....), ka dale nga Republika e Shqipërisë me dokumentin, pasaporte e zakonshme kineze, me numër (.....)-CN, me datën **15.09.2012 ora 19:14** me linjën ajrore **TURKISH AIRLINESTK 1473/1474 STAMB**, ne Aeroportin Ndërkombëtar “Nene Tereza” - Rinas.

Pra rezulton se ky shtetas ndodhej jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë qe nga data 15.09.2012, nderkohe qe derdhja e shumes prane Alfa Banka e parave ne Cash figuron te jete bere me date 08.11.2012 dhe rezulton se ky shtats eshte paraqitur personalisht pasi ka nenshkruar emer te tij .

Nisur nga sa me siper gjykata cmon se kerkesa duhet te pranohet si e bazuar ne prova dhe ne ligj pasi nga aktet e paraqitura per kete kerkesë ekziston dyshimi i arsyeshem qe shtetasi

(.....) ka kryer veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. dhe ekziston dyshimi se kemi të bëjmë me produkte të veprës penale për të cilat ekziston rreziku të transferohen me qëllim fshehjen dhe mbulimin e origjinës së këtyre produkteve, për shkak të kërkesës që ky shtet i ka drejtuar ALPHA Bank.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 274 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 36 të K.Penal:

VENDOSI

1. Venien e « Sekuestros Preventive » mbi llogaritë bankare si më poshtë:

1. Llogaria bankare në dollarë në vlerën (.....) USD, derdhje nga shtetasi (.....). Nr. I Llogarise (.....).
2. Llogaria bankare në dollarë në vlerën (.....) USD, derdhje nga shtetasi (.....). Nr. I Llogarise (.....)

2. Per ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen O.P.GJ të Drejtorisë Kunder Krimit Financiar në Departamentin për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3. Kunder këtij vendimi lejohet të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit ose nga dita e marrjes së diçës prej personit të interesuar.

U Shpall në Tiranë sot në datë 14.11.2012

**Sekretare
Soeda Docaj**

**Gjyqtare
Eneida Civici**